

Je nën moshën 18 vjeç dhe dyshohesh se ke kryer një vepër penale?



Drejtësia do të jetë miqësore me ty!

Kufizimi ose heqja e lirisë tënde do të përdoret vetëm si një masë e fundit, kur një masë më e butë nuk mund të zbatohet dhe për një kohë sa më të shkurtër!

Nëse ke mbushur moshën 14 vjeç dhe dyshohesh se ke kryer një vepër penale atëherë ndaj teje mund të fillojë procesi penal dhe në disa raste, ti mund të ndalohesh apo të arrestohesh nga Policia. Atëherë ti duhet të dish se ke disa të drejta.



Ti ke të drejtë;

- të dish pse të kanë ndaluar apo arrestuar, çfarë do të ndodhë me ty dhe si të lajmërosh prindërit apo kujdestarin;
- të të plotësohen të gjithë nevojat si: veshmbathje, ushqim, kujdes shëndetësor, etj.
- të kesh një avokat falas. Ai do të të mbrojë ty dhe do të të tregojë çfarë do të ndodhë hap pas hapi;
- të kesh një psikolog falas, i cili do të të mbështesë gjatë gjithë procesit.

**Kujdes!**

Nëse nuk dëshiron të njoftosh prindërit, mund të njoftosh një familjar apo njeri të besuar. Nëse nuk e kupton informacionin kërko të ta shpjegojnë më thjesht e më qartë. Nëse ke vështirësi në dëgjim, të folur, shikim etj, kërko një interpretues apo lehtësues falas.



Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, psikologu dhe avokati janë aty për të të mbështetur ty.



Ata do të ruajnë çdo sekret tëndin. Tregoju atyre për çdo shqetësim, keqtrajtim, paqartësi, problem shëndetësor dhe çdo nevojë që mund të kesh.



Ti ke të drejtë të trajtohesh me respekt e me dinjitet dhe të mos keqtrajtohesh fizikisht apo psikologjikisht.

Mos ngurro të bësh pyetje dhe të kërkoesh informacion!

Nëse ndihesh i lodhur gjatë marrjes në pyetje, kërko pushim.

Ndalohet marrja në pyetje e të miturit gjatë natës, nga ora **22:00 - 08:00**.

Nëse je i uritur, i etur, ke ftohtë apo ke nevojë për të përdorur tualetin, kërko.



**Kujdes!**

Në çdo kohë ti mund:

- ✓ të kërkoesh të dëgjohesh;
- ✓ të shprehësh lirshëm mendimin tënd.



Ti ke të drejtë të heshtësh dhe të mos japësh asnjë dëshmi apo të pranosh fajin. Heshtja jote nuk sjell asnjë pasojë për ty!

Prindërit apo kujdestari mbrojnë interesat e tua dhe ti ke të drejtë që t'i kesh të pranishëm përgjatë gjithë procesit.

### Kujdes!

Nëse prania e prindit apo kujdestarit të shqetëson mos ngurro t'ia përcjellësh këtë shqetësim prokurorit, avokatit apo psikologut



Jeta jote private është e mbrojtur!

Askush nuk lejohet të publikojë emrin, foton apo të dhënat e tua dhe të familjes tënde.

Në seancat gjyqësore nuk do të lejohet pjesëmarrja e publikut.

### Ruaj qetësinë!

Sistemi i Drejtësisë për të Mitur nuk kërkon ndëshkimin tënd. Përkundrazi, ai i jep përparësi shmangies tënde nga ndjekja penale. Të gjithë vendimet dhe veprimet e ndërmarra ndaj teje duhet të kryen në mënyrë të shpejtë dhe pa vonesa të pajustificuara.

Ajo çka duan të gjithë është që ti të ndryshosh sjelljen, të vazhdosh shkollën, të bëhesh i zoti ose e zonja, të bësh zgjedhjet e duhura larg krimit dhe të kesh një jetë sa më të mirë.

Nëse ke nevojë për ndihmë dhe mbështetje apo nëse të drejtat e tua janë cenuar:

Kontakto punonjësën për mbrojtjen e fëmijës të zonës ku ndodhesh. Numrin e tij e gjen në adresën e internetit:

<http://femijet.gov.al/al/njesite-per-mbrojtjen-e-femijeve>

Telefona falas:  
Alo 116 111



Për më shumë informacion mbi të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin konsultoni faqet e internetit:

Qendra për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve: <http://www.qpkmr.gov.al>  
Qendra ALTRI: <http://www.altri.al>



Çdo fëmijë meriton një mundësi të re!

Drejtësia do të jetë miqësore me ty!



Tiranë, maj  
2021



Norwegian Ministry  
of Foreign Affairs



A.L.T.R.I

unicef  
for every child

Ky material u përgatit nga Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (Qendra ALTRI) për Ministrinë e Drejtësisë dhe Zyrën e UNICEF-it në Shqipëri, me mbështetjen financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë